



**AKT THEMELUES
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MERLA - SHQIPRIK" sh.p.k**

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar", me vullnetin tone te lire ne kerkuesit, Shkurt Lasku i biri i Ndues dhe Prendes, dtl.05.07.1968, lindur ne Puke dhe banues ne Tirane, Rr. "Bedri Karapici, Lagjia 6, Qyteti i Nxenesve, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga certifikata dhe Dritan Jace i biri i Ivanit dhe Tatjanes, dtl.26.06.1972, lindur ne Kruje, banues ne Tirane, Rr. "Hamdi Pepa, Lagjia Selite e Vogel, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga certifikata, ne baze te legjislacionit shqiptar vendosa te hartoj aktin e themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar si me poshte:

**KREU I
FORMIMI**

NENI 1

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"MERLA - SHQIPRIK"** sh.p.k. Shoqeria do t'i nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

**KREU II
VENDQENDRIMI I SHOQERISE**

NENI 2

Vendqendrimi i shoqerise **"MERLA - SHQIPRIK"** sh.p.k do te jete me seli ne adresen: Rr. "Bedri Karapici", Lagjia 6, Qytetit i Nxenes. Shoqeria do te hape dhe vendqendrim te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi ne te gjithe teritorrin e Republikes se Shqiperise dhe me miratim te organeve kopetente dhe jashte vendit.

**KREU III
OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

NENI 3

Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice import, eksport te artikujve te ndryshem ushqimore, si fruta – perime etj, industriale, konfeksione, veshmbathje, kepuce te reja dhe te persorura, hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike. Si dhe cdo aktivitet tjeter qe veomas ose se bashku me te lartpermendurit konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per shoqerine.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhimi, perpunimi, sherbimi, tregtimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj.

KREU IV KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregtar, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

KREU V KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise **“MERLA - SHQIPRIK”** sh.p.k do te jete 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ne:

- Shkurt Lasku – 50 % te kuotave = 50.000 leke
- Dritan Jaçe – 50 % te kuotave = 50.000 leke

Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaku i vetem duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruaje sekretin e saj dhe te mosdemtoje interesat e personave te tjere dhe te shoqerise.

KREU VI DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do të drejtohet nga administratori i saj, z.Shkurt Lasku.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut themelues te shoqerise.

NENI 10

Ortaku themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktojte financiere, likujdatore per problemet e shoqerise, si dhe te pajtojte persona te tjere si ortake. Financieri nxjerr regullisht treguesit financiare tremujore, gjashtemujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

NENI 11

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar.

NENI 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme, me tekstin per rrethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kopetente.

NENI 15

Ky Akt Themelimi perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "MERLA - SHQIPRIK" sh.p.k. Akti i themelimit neshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.



ORTAKU THEMELUES
SHOQERISE "MERLA - SHQIPRIK" SH.P.K

SHKURT LASKU


DRITAN JAÇE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 1540 Rep NR. 670 Kol

VERTETIM

Ne Tirane sot me dt. 11.02.2006 u paraqiten para meje noterit Silvana Merko, anetar i Dhomes se Noterise Tirane, z. Shkurt Lasku i biri i Ndues dhe Prendes, dtl.05.07.1968, lindur ne Puke dhe banues ne Tirane, Rr. "Bedri Karapici, Lagjia 6, Qyteti i Nxenesve, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga certifikata dhe Dritan Jaçe i biri i Ivanit dhe Tatjanes, dtl.26.06.1972, lindur ne Kruje, banues ne Tirane, Rr. "Hamdi Pepa, Lagjia Selite e Vogel, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga certifikata, te cilet me deklaruan se sa me siper Akti i Themelimit dhe Statuti eshte shprehur vullneti i tyre i lire dhe i plote te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "MERLA - SHQIPRIK" Sh.p.k dhe nenshkruhet pa verejtje ne pranine time gje te cilen une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTER



NOTERE

Silvana Merko
Cel: 0682074214



S T A T U T I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“MERLA - SHQIPRIK” sh.p.k

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 “Per regjistrin tregetar”, me vullnetin tone te lire ne kerkuesit, Shkurt Lasku i biri i Ndues dhe Prendes, dtl.05.07.1968, lindur ne Puke dhe banues ne Tirane, Rr. “Bedri Karapici, Lagjia 6, Qyteti i Nxenesve, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga certifikata dhe Dritan Jace i biri i Ivanit dhe Tatjanes, dtl.26.06.1972, lindur ne Kruje, banues ne Tirane, Rr. “Hamdi Pepa, Lagjia Selite e Vogel, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga certifikata, ne baze te legjislacionit shqiptar vendosem te hartojme statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar si me poshte:

KREU I

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emerohet **“MERLA - SHQIPRIK” sh.p.k** me ortak z.Shkurt Lasku dhe z.Dritan Jace.

NENI 2

Selia e shoqerise **“MERLA - SHQIPRIK” sh.p.k** do te jete ne adresen: Rr. “Bedri Karapici”, Lagjia 6, Qytetit i Nxenesve.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregtar, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj :

Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice import, eksport te artikujve te ndryshem ushqimore si fruta – perime etj, industriale, konfeksione, veshmbathje, kepuce te reja dhe te persorura, hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike. Si dhe cdo aktivitet tjeter qe vecmas ose se bashku me te lartpermendurit konsiderohet i pershtatshem e me leverdi per shoqerine.



KREU II KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise "**MERLA - SHQIPRIK**" sh.p.k do te jete 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ne:

z. Shkurt Lasku dhe – 50 % te kapitalit = 50.000 leke

z.Dritan Jace – 50 % te kapitalit = 50.000 leke

Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakut themelues te shoqerise por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

NENI 6

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj, te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 7

Kuota e kapitalit fillestar eshte derdhur nga ortaku themelues ne banke, ne llogarine bankare te shoqerise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise se shoqerise.

NENI 8

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, i takojne ortakut themelues, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

NENI 9

Shoqeria "**MERLA - SHQIPRIK**" sh.p.k eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise shoqeria "**MERLA - SHQIPRIK**" sh.p.k gezon te drejta sikunder çdo person tjeter juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 10

Shoqeria "MERLA - SHQIPRIK" sh.p.k vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejtat e detyrimit vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku themelues i shoqerise mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

KREU III DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 11

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, z. Shkurt Lasku.

NENI 12

Hyjne brenda detyrave dhe kopetencave te ortakut themelues si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.
2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe bilancit te llogarise vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen shoqeria.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise.

Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

NENI 13

Administratori jo ortak perveç detyrave qe i caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto detyra te tjera:

1. Te mireadministroje pasurine e shoqerise
2. Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortakut themelues.
3. Te zbatoje rregulloren e brendshme te shoqerise.
4. Te pergjigjet per demet qe i sjell shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marreveshjes se bere me ortakun themelues.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithçka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.

7. Të kryeje të gjitha veprimet bankare që kanë të bëjnë me llogarë dhe shoqëri.

KREU IV TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQËRIE

NENI 14

Shoqëria ka të drejtë:

1. Të kryeje veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë.
2. Të sigurojë pasurinë e vet.
3. Të marrë kredi në lekë dhe në valutë nga bankat vendase dhe të huaja në bazë të rregullave ligjore.
4. Të përfitojë nga favorët që i njeh legjislati shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera.
5. Të investojë kudo në Shqipëri nga të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj.
6. Të punësojë punëtorë të thjeshtë ose të kualifikuar, vendas ose të huaj.
7. Të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 15

Shoqëria ka për detyrë:

1. Të sigurojë kapitalin themeltar në formën dhe kohën e duhur. Të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria.
2. Të sigurojë punonjësit e saj.
3. Të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo. Të respektojë standartet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

KREU V MARREDHENIET EKONOMIKO – FINANCIARE TE SHOQËRIE

NENI 16

E gjithë veprimtaria e shoqërisë për plotësimin e objektit të veprimtarisë së saj, pasqyrohet në bilancin ekonomik të saj.

NENI 17

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda muajit mars te vitit pasardhes nxirret bilanci.

NENI 18

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 19

Shoqeria mban xhiro – llogarite ne banke. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkates.

NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqeria, pasi ben zbritjen e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5 % te fitimit, me te cilin krijohet fondi “Rezerve e domosdoshme”, derisa ky fond te arrije masen 10 % te kapitalit themeltar.

NENI 21

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale i mbesin ne perdorim ortakut themelues te shoqerise.

Konvertimi i parase se realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete banka e Shtetit Shqiptar, ose bankat e tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

KREU VI DEPOZITA TE VEÇANTA

NENI 22

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

KREU VII SHNDERRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE NENI 23

Shnderrimi i shoqerise “**MERLA - SHQIPRIK**” sh.p.k ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te ortakut themelues.

NENI 24

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak si:

- Humbja e kapitalit të shoqërisë
- Pamundësi veprimi.
- Me vendim të asamblesë së ortakëve.

Në këto raste, pronari i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatore duke iu përcaktuar edhe detyrat.

Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë derisa ajo t'iu dorëzohet personave përkates fizik dhe juridikë, duke u likuiduar në radhë të parë detyrimet ndaj personave të tretë që ka shoqëria. Në rast se fondet disponibel, rezultojnë të pamjaftueshme, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakut themelues të shoqërisë që të derdhe interesisht kuotat që i takojnë atij.

KREU VIII DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 25

Përsa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut, referohen plotësimet që do të bëhen nga ortakut themelues, si edhe ligjeve të veçanta të legjislacionit Shqiptar.


Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në mënyrën dhe procedurën me të cilën nxirret vete statuti.

NENI 26

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'iu shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "MERLA - SHQIPRIK" sh.p.k.

ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË "MERLA - SHQIPRIK" SH.P.K

SHKURT LASKU



DRITAN JAÇE

